

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Supervizion “F.V elektropompa dhe panele elektrike për stacionin e pompave Fushë-Kuqe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimit

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve/termave të referencës të hartuara, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”..

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,682,088.80 (nje milion e gjashtëqind e tetedhete e dy mije e tetedhete e tete presje tetedhete) lekë pa tvsh.

Afati i realizimit është 6 muaj

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Argumentim:

Për perlloritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **Supervizion “F.V elektropompa dhe panele elektrike për stacionin e pompave Fushë-Kuqe”.**

Mbështetur në Seksioni III “VEPRA INXHINIERIKE”

“Tabela shoqëruese e tarifave -”, *GRUPI TARIFOR II*

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim të punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licencë profesionale të shoqërisë për supervizion punimesh të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente të tyre:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-7 a. Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TVN.S-2 -Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, etj.

Licensa duhet të jete leshuar sipas rregullave të VKM nr 759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentim:

- NP-7 a. (Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime të instalimit të pompave të cilat janë pjesë e skemes së ujesjellesit.
- NP-11 (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime të zbatimit të paneleve elektrike, kabull tensioni etj.
- N.S- 14 (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TVN.S-2 -Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, etj) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime të zbatimit të kabllove, vendosje kabull ethernet etj.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (drejtues teknik) , të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj, si dhe CV-në e tyre, diplomat, kontratë individuale pune të noterizuar dhe liçencën personale të mbikqyrjes të tyre. Drejtuesit teknike të kërkuar më poshtë duhet të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për muajin e fundit nga dita e hapjes së tenderit (formularet E-ig025/a.1):

Ka si drejtues teknik të punësuar dhe të përfshirë në liçencën e shoqërisë minimalisht:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi/ Hidroteknik

- 1(një) Inxhinier Elektrik

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi/Hidroteknik (me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, dhe certifikimin e paisjevehidraulike, popma etj)
- 1(një) Inxhinier Elektrik (Mbikqyrësin për punimet elektrike me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.)

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.2 Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Në rast se oferta është me e ulët se minimumi i përcaktuar në këtë vendim ajo do të skualifikohet. Ky kriter bazohet në rekomandimin e APP-se me shkresat Nr.5585 Prot. me datë 25.07.2017. Ofertuesit duhet të plotësojnë në mënyrë rigorozë ofertën sipas shtojcës 1. Ofertuesit në përgatitjen e ofertës duhet të kenë parasysh që të mos tejkalojnë vlerën e fondit limit për çdo projekt. Mosplotësimi i saktë i kësaj oferte përben kusht për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Jane hedhur se bashku me dokumentat teknike të tenderit ku janë shprehur qartë kërkesat AK për cilësinë e të gjithë punimeve dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e kontrates.

